



Funded by the
European Union



RISE Balkans

*Fuqizimi i Zërit të të Rinjve: Përgjegjësi, Integritet, Solidaritet dhe
Angazhim Qytetar në Ballkan*

THIRRJE E HAPUR PËR PJESËMARRJE NË PROGRAMIN E TRAJNIMIT PËR TRAJNERË “TË RINJTË SI NXITËS TË ANGAZHIMIT QYTETAR”

Partnerët Shqipëri fton të rinj (18-26 vjeç) të interesuar për t'u bërë pjesë e një programi **“Trajnimi për Trajnerë”** me temë: **“Të Rinjtë si Nxitës të Angazhimit Qytetar” (Youth Civic Drivers)**.

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të trajnohen për të luajtur rolin e **bashkë-lehtësuesit të Klinikave të Qeverisjes së Mirë** – workshope interaktive dhe tematike të hartuara për ta sjellë qeverisjen më afër qytetarëve dhe për t'i pajisur të rinjtë me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për ta bërë zërin e tyre të dëgjohet.

Ky është një program i strukturuar për zhvillimin e lidershit midis të rinjve, nëpërmjet trajnimit të dedikuar dhe mentorimit të vazhduar për ti asistuar në ideimin e iniciativave konkrete me fokus nxitjen e qeverisjes së mirë dhe transparencës.

Çfarë është një Nxitës i Angazhimit Qytetar?

Një Nxitës i Angazhimit Qytetar është një i ri (18-26 vjeç) i cili:

- Beson në rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe qytetarisë aktive;
- Është i gatshëm të mësojë dhe më pas t'u transmetojë të tjerëve parimet e qeverisjes së mirë;
- Mund të angazhohet në një program të strukturuar dhe të lehtësojë aktivitete në vijim përgjatë zbatimit të projektit;
- Dëshiron të bashkë-hartojë aktivitete të reja të edukimit dhe ndërgjegjësimit qytetar bazuar në nevojat dhe interesat reale të bashkëmoshatarëve të tyre.



Funded by the
European Union

Struktura e Programit

Të Rinjtë e përzgjedhur si “Nxitës të Angazhimit Qytetar” do të marrin pjesë në fazat e mëposhtme të projektit:

Faza	Aktiviteti	Përshkrimi
1	Përzgjedhja	Përmes thirrjes të hapur për aplikime
2	Trajnimi i Trajnerëve (Training of Trainers) TOT	Program trajnimi me pjesëmarrje fizike mbi aftësitë e lehtësimit, parimet e qeverisjes së mirë, pjesëmarrjen demokratike, angazhimin e udhëhequr nga të rinjtë, etj.
3	Klinikat e Qeverisjes së Mirë	Bashkë-lehtësimi i Klinikave tematike për Qeverisjen e Mirë nga të Rinjtë së bashku me ekspertët e projektit
4	Bashkë-hartimi i aktiviteteve	Propozimi, zhvillimi dhe udhëheqja e aktiviteteve të reja të edukimit qytetar bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve.

Çfarë ofrojmë?

Të Rinjtë e përzgjedhur si “Nxitës të Angazhimit Qytetar” do të përfitojnë nga ky program:

- Pjesëmarrje fizike në një program të strukturuar Trajnim i Trajnerëve (Training of Trainers)
- Mentorim të vazhdueshëm dhe mbështetje nga ekspertë;
- Përfshirje aktive në hartimin dhe zbatimin e iniciativave të reja të edukimit qytetar;
- **Certifikatë e ndjekjes së Programit** e lëshuar pas përmbushjes me sukses të të gjitha angazhimeve të programit;
- Mundësi rrjetëzimi me bashkëmoshatarë, organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe ekspertë të qeverisjes nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor,
- Mundësi për arsimim të mëtejshëm, angazhim qytetar dhe zhvillim personal.

Kush mund të aplikojë?

Kjo thirrje është e hapur për të rinjtë që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Mosha	18 -26 vjeç
Vendbanimi	Shqipëri
Disponueshmëria	I/E gatshëm/me të angazhohet gjatë gjithë programit, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnimet me prezencë fizike, lehtësimin e Klinikave të Qeverisjes së mirë dhe kontribut në aktivitetet e bashkë hartimit të iniciativave të reja.
Motivimi	I/E interesuar për angazhimin qytetar, demokracinë, transparencën dhe fusha të ngjashme.



Funded by the
European Union



Si të aplikoni?

Aplikimet duhet të dërgohen deri më **15.07.2026**, përmes plotësimit të formularit zyrtar të aplikimit online të disponueshëm në këtë link: [FORMULAR APLIKIMI PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIMIN PËR TRAJNERË PËR TË RINJTË SI NXITËS TË ANGAZHIMIT QYTETAR – Fill in form](#)

Të gjitha aplikimet që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë do të shqyrtohen në përputhje me kërkesat e kësaj thirrjeje, dhe aplikantët do të njoftohen në vijim për rezultatin përfundimtar.

Pyetje dhe kontakt

Për çdo pyetje në lidhje me këtë Thirrje të Hapur, ju lutemi kontaktoni:

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim : partners@partnersalbania.org